



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

**V E N D I M**

**Nr. 96 , datë 10.12.2018**

**PËR**

**“SHQYRTIMIN E ANKIMIT TË SIPËRMARRËSIT NEOFONE SH.P.K., ME OBJEKT:  
“MOSDHËNIA E AKSESIT NË RRJET DHE MOSARRITJA E LIDHJES SË  
MARRËVESHJES SË INTERKONEKSIONIT PËR TERMINIMIN E THIRRJEVE  
NDËRKOMBËTARE NË RRJETIN E ALBTELECOM SH.A.”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

<b>Z.</b>	<b>Ilir Zela</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Znj.</b>	<b>Ketrin Topçiu</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Znj.</b>	<b>Klarina Allushi</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Znj.</b>	<b>Edlira Dvorani</b>	<b>Anëtare</b>

dhe sekretare Sindi Dushku, në mbledhjen e datës 10.12.2018, shqyrtoi çështjen me objekt:

- 1. Shqyrtimin e ankimit të sipërmarrësit Neofone sh.p.k, me objekt: “Mosdhënia e aksesit në rrjet dhe mosarritja e lidhjes së Marrëveshjes së Interkoneksionit për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare në rrjetin e Albtelecom sh.a”*

**BAZA LIGJORE:**

1. Ligji nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*Ligji nr. 9918/2008*);
2. Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (*Ligji nr. 44/2015*);

3. Rregulloren nr. 19, datë 14.6.2010 “Për Aksesin dhe Interkoneksionin”, e ndryshuar (**Rregullore Nr.19**);
4. Rregulloren e Brendshme të Funkcionimit të Këshillit Drejtues të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP (**Rregullore Nr.7**);
5. Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr.89, datë 15.11.2018 për “Shfuqizimin e vendimit nr.78, datë 01.10.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e dokumentit: “Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare – Dokument Përfundimtar”, dhe shfuqizimin e Vendimeve të Këshillit Drejtues, përkatësisht vendimet nr.79, nr.80, nr.81 dhe nr.82, datë 01.10.2018;

### **K Ë S H I L L I D R E J T U E S I A K E P :**

Pasi shqyrtoi materialin shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e Neofone sh.p.k., me nr. 2423/5 Prot, datë 07.11.2018, “Ankesë” me objekt: “Mosdhënia e aksesit në rrjet dhe mosarritja e lidhjes së Marrëveshjes së Interkoneksionit për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin e Albtelecom sh.a”, drejtuar për kompetencë AKEP;
- Ankesa e subjektit Neofone sh.p.k. drejtuar AKEP me bazë ligjore të mbështetur në nenet 42,46,47,50,60 të ligjit nr. 9918/2008 si dhe nenit 41 e vijues të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (ligji nr. 44/2015);
- Shkresa e Neofone sh.p.k., nr. 327 prot., datë 10.10.2018, drejtuar Albtelecom (administruar në datë 15.10.2018) dhe për dijeni AKEP (nr. 2423/2 Prot, datë 15.10.2018) me objekt: "Kërkesë për ofertë interkoneksioni për lidhjen e marrëveshjes teknike dhe ekonomike për akses dhe interkoneksion për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt abonenteve të rrjetit Albtelecom sh.a."
- Shkresa e Albtelecom nr.10465/1 Prot, date 24.10.2018 "Pergjigje e shkreses nr. 327 dt. 10.10.2018 të Neofone (nr.10465 prot. Albtelecom, dt.15.10.2018), sipas së cilës refuzon kërkesën për paraqitjen e ofertës së kërkuar dhe vijimin e negociatave për një marrëveshje me Neofone për ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt rrjetit Albtelecom dhe për dijeni AKEP, prot nr.2423/3 datë 24.10.2018;
- Shkresa e Neofone sh.p.k. drejtuar Albtelecom , “Kthim pergjigje mbi shkresen nr. 10655/1 datë 24.10.2018”, dhe për dijeni AKEP me nr. 2423/4 Prot, datë 01.11.2018;
- Projekt Vendimi i arsyetuar;
- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (Relacioni),

si edhe pasi e diskutoi në tërësi çështjen,

### **V Ë R E N :**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore, pasi mori në shqyrtim ankesën e sipërmarrësit Neofone sh.p.k, me nr. 2423/5 Prot, datë 07.11.2018, me objekt: “*Mosdhënia e aksesit në rrjet*

dhe mosarritja e lidhjes së Marrëveshjes së Interkoneksionit për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombetare në rrjetin e Albtelecom sh.a”, drejtuar për kompetencë AKEP, ka konstatuar si vijon:

➤ ***Nga korrespondenca shkresore e zhvilluar ndërmjet palëve Neofone sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a. e renditur më sipër, korrespondencë e cila paralelisht është dhe dërguar për dijeni në AKEP, ankesa e paraqitur dhe pretendimet e sipërmarrësit Neofone sh.p.k. mund të përmbliidhen sipas pikave më poshtë:***

1. Neofone sh.p.k me shkresën nr. 2423/5 Prot datë 07.11.2018, ka kërkuar shqyrtimin e ankesës për: “Mosdhënie të aksesit në rrjet dhe mosarritja e lidhjes së Marrëveshjes së Interkoneksionit për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombetare në rrjetin e Albtelecom sh.a.”.
2. Neofone sh.p.k sqaron se, sipas përcaktimeve ligjore të parashikuara në nenet 13, 14 dhe 15 të ligjit nr. 9918 dhe kuadrit rregullator në fuqi në zbatim të këtij ligji është regjistruar në regjistrin e sipërmarrësve në AKEP me numër 140 për ofrimin e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, përfshirë shërbimet e Tranzit Kombëtar dhe Tranzit Ndërkombëtar.
3. Sipërmarrësi Neofone, sqaron se në mbështetje të nenit 47 dhe nenit 48 të ligjit nr. 9918, me shkresë nr.327 prot.,datë 10.10.2018 "Kërkesë për ofertë interkoneksioni për lidhjen e marrëveshjes teknike dhe ekonomike për akses dhe interkoneksion për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare drejt abonentëve të rrjetit Albtelecom sh.a." iu drejtua sipërmarrësit Albtelecom për një ofertë interkoneksioni për të mundësuar ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike dhe bashkëveprimin e shërbimeve.
4. Sipërmarrësi Albtelecom, me shkresë nr. 10465/1 Prot., datë 24.10.2018 "Përgjigje shkresës suaj nr. 327 dt. 10.10.2018 (nr. 10465 prot. Albtelecom, dt. 15.10.2015) refuzon kërkesën për paraqitjen e ofertës së kërkuar dhe vijimin e negociatave për një marrëveshje me Neofone për ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare drejt rrjetit Albtelecom;
5. Neofone sh.p.k. duke referuar zbatimin e parashikimeve ligjore të përcaktuara në nenin 50 dhe nenin 60 të ligjit nr. 9918/20018, në kushtet kur marrëveshja teknike dhe ekonomike për akses dhe interkoneksion për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt pajtimtarëve të rrjetit Albtelecom, nuk është arritur, kërkon nga AKEP si organi kompetent për shqyrtimin e ankimit dhe nxjerrjen e vendimit të shoqëruar me urdhërin përkatës lidhur me:

- a) Detyrimin për akses dhe interkoneksion sipas nenit 42 të ligjit nr. 9918/2008 për sipërmarrësin Albtelecom sh.a, të deklaruar me FNT në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare sipas VKD nr. 78;
- b) Detyrimin për lidhjen e marrëveshjes të aksesit dhe interkoneksionit ndërmjet sipërmarrësve Albtelecom Sh.a dhe Neofone sh.p.k. për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare drejt abonentëve të rrjetit Albtelecom.

6. Neofon shpk në funksion të kërkesës ankimore, referuar përcaktimeve të nenit 50 dhe 60 të ligjit nr. 9918, specifikon:

- Koha kur është kërkuar interkoneksioni për ofrimin e shërbimit te terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin e sipërmarrësit Albtelecom është ajo e depozitimit të shkresës nr. 327 prot. date 10.10.2018 "Kërkesë për ofertë interkoneksioni për lidhjen e marrëveshjes teknike dhe ekonomike për akses dhe interkoneksion për terminimin e thirrjeve ndërkombetare drejt abonentëve të rrjetit Albtelecom sh.a" (shkresë kjo dërguar nga Neofone datë 10.10.2018 dhe rregjistruar në Albtelecom datë 15.10.2018).
- Referuar shkresës nr. 1046511 Prot., datë 24.10.2018 të sipërmarrësit Albtelecom sh.a "Përgjigje shkresës tuaj nr. 327 dt. 10.10.2018", sipërmarrësi Albtelecom sh.a, bazuar në pretendimet e tij, nuk ka pranuar të zhvillojë negociatë me sipërmarrësin Neofone për lidhjen e marrëveshjes teknike dhe ekonomike për aksesin dhe interkoneksionin, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9918 dhe kuadrin rregullator në fuqi.

➤ ***Pretendimet e sipërmarrësit Albtelecom sh.a në shkresën nr.10465/1 Prot, datë 24.10.2018 "Përgjigje e shkresës nr.327 dt.10.10.2018 të Neofone (nr.10465 prot. Albtelecom, dt.15.10.2018), sipas së cilës refuzon kërkesën për paraqitjen e ofertës së kërkuar dhe vijimin e negociatave për një marrëveshje me Neofone për ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare drejt rrjetit Albtelecom dhe për dijeni AKEP, prot. nr.2423/3 datë 24.10.2018, referohen si në vijim:***

1. Ndërmjet sipërmarrësve Albtelecom dhe Neofone , aktualisht nuk disponohet asnjë akt apo Marrëveshje për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare drejt abonentëve të rrjetit Albtelecom" sh.a;
2. Në VKD nr. 78 dhe VKD nr. 80 të AKEP të cilave sipërmarrësi Neofone ka referuar në kërkesën shkresore drejtuar Albtelecom duke i referuar si bazë ligjore, AKEP nuk ka vendosur detyrimin për akses në kuptim të nenit 39 të ligjit nr. 9918;
3. Referimi i sipërmarrësit Neofone në kërkesën drejtuar Albtelecom, në nenin 47 të ligjit nr. 9918 nuk është i mbështetur pasi ky nen ka të bëjë me sigurimin e komunikimit të përdoruesve të rrjeteve respektive të palëve që zhvillojnë aktivitetin brenda territorit të Shqipërisë, si dhe nuk ka lidhje aspak me terminimin e thirrjeve

ndërkombëtare, pra origjinohen nga përdorues të rrjeteve të sipërmarrësve në shtetet e tjera të botës, pra jashtë territorit të Shqipërisë për rrjetin e Albtelecom;

4. Albtelecom për sa më sipër, konsideron se kërkesa e Neofon sh.p.k. është e pabazuar ligjërisht dhe gjithashtu nuk shikon interes në paraqitjen e një oferte për kërkesën e paraqitur për të vijuar negociatat për një marrëveshje me këtë subjekt për ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare drejt rrjetit Albtelecom;

## **II. VLERËSIMI I KËSHILLIT DREJTUES**

1. Neofone sh.p.k. kërkon të investojë Këshillin Drejtues të AKEP si organ kompetent, në shqyrtimin e ankesës si procedim administrativ, duke kërkuar që Këshilli Drejtues të nxjerrë Urdhër për lidhjen e Marrëveshjes së Interkoneksionit ndërmjet Neofone sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a ne perputhje me percaktimet e Vendimeve te Këshillit Drejtues nr.78 dhe nr.80 datë 01.10.2018 për “Miratimin e dokumentit: “Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare – dokument përfundimtar” si dhe për “Përcaktimin e Sipërmarrësit Albtelecom sh.a. me fuqi të ndjeshme në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare si dhe masat përkatëse Rregullatore”, te cilat në momentin e paraqitjes së kërkesës përkatëse të subjektit Neofone shpk ishin në fuqi.
2. Bazuar në Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr.89, datë 15.11.2018 për “Shfuqizimin e vendimit nr.78, datë 01.10.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e dokumentit: “Analizë e tregut celular: tregu me shumicë i aksesit dhe origjinimit; tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe tregu me pakicë i shërbimeve celulare – Dokument Përfundimtar”, si dhe shfuqizimin e Vendimeve të Këshillit Drejtues, përkatësisht vendimet nr.79, nr.80, nr.81 dhe nr.82, datë 01.10.2018, konstatohet se kërkesa ankimore e subjektit Neofone, mbetet një kërkesë e referuar për ndërhyrje administrative nga ana e AKEP, që lidhet me shërbimin e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, shërbim i cili është i rregulluar plotësisht nga AKEP, kështu që çdo marrëveshje e mundshme midis palëve mbetet plotësisht e ndërtuar mbi baza komerciale.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në pikën 1 të nenit 114-të Ligjit nr. 9918/2008 “Për Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe Ligjit nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP:

### **VENDOSI:**

1. Të mos fillojë procedimin administrativ për ankesën e paraqitur nga sipërmarrësi Neofone.
2. Ngarkohet Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara Neofone sh.p.k dhe Albtelecom Sh.a.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afatit 45 ditor të përcaktuar në Ligjin 49/2012.
4. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Anëtar**

**Ilir ZELA**

**Edlira DVORANI**

**Klarina ALLUSHI**

**Ketrin TOPÇIU**